



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 6/13 prot.

Datë 21.02.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 204/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 97/2024, datë 26.01.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Atom” SHPK me NUIS L22203042N, me adresë: Rruga “Islam Alla”, Pallati 56, Kati 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me adresë: “Rruga e Dibrës”, Nr. 371, 1005, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 97/2024, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur të operatorit ekonomik “Atom” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-85785-10-30-2023 me objekt “Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Atom” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Atom” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr.3058/56 prot., datë 07.02.2024, protokolluar me tonën nr. 06/10 prot., datë 08.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.97/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-85785-10-30-2023 me objekt “Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.3058/56 prot., datë 07.02.2024, protokolluar me tonën nr. 06/10 prot., datë 08.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.97/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 97/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, duke skualifikuar operatorin ekonomik “BNT Electronics” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

